



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura IV  
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit  
P-160  
Prishtinë, më 3 prill 2014

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 3, 7 DHE 10 PRILL 2014**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së parë plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

**1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Blerta Deliu-Kodra, Haki Demolli, Faton Topalli, Ahmet Isufi, Jeton Svirca, Agim Kuleta, Halit Krasniqi, Alma Lama, Hykmete Bajrami, Jakup Krasniqi, Florin Krasniqi, Sabri Hamiti, Teuta Haxhiu, kryeministri Hashim Thaçi dhe ministri Ferid Agani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

\* \* \*

Në vazhdim, kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, propozoi që pika - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të radhitet në rendin e ditës si pikë me numrin rendor dy.

Kuvendi miratoi propozimin e kryetarit të Kuvendit, Jakup Krasniqi.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë për linjën kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale.

\* \* \*

Para se të kalohet në pikat e radhës, kryetari e njoftoi Kuvendin se deputetët Lumnije Morina dhe Emin Gërbeshi, kanë njoftuar nëpërmjet një shkrese se nga tash do të jenë pjesë e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

\* \* \*

### **2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës**

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Deputeti Fikrim Damka, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e paraqiti dhe e arsyetoi para deputetëve raportin me rekomandime.

Kryetari më pas i hodhi në votim amendamentet, veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 5A, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, dhe 20.

Kuvendi nuk miratoi këto amendamente: 2, 3, 4, 5B, 6, 7 dhe 8.

Në lidhje me amendamentet nr. 3 dhe 4 të propozuara nga Grupi Parlamentar i LDK-së, arsyetimin e paraqiti deputeti Anton Quni.

Diskutimi i deputetit Anton Quni është dhënë i plotë në transkript.

Më pas lidhur me amendamentet e lartpërmendura diskutuan deputetët: Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi, Anton Quni, Armend Zemaj, Daut Haradinaj, Sabri Hamiti dhe kryeministri Hashim Thaçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas kësaj, Grupi Parlamentar i LDK-së e lëshoi sallën e mbledhjeve.

Fikrim Damka, kryetar i Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, sqaroi se në amendamentin nr.17, te neni 31, duhet të shtohet fjalia: “dhe fëmijët e tyre”.

Diskutimi i deputetit Fikrim Damka është dhënë i plotë në transkript.

Deputeti Faton Topalli diskutoi në lidhje me amendamentet nr. 18 dhe 19 të propozuara nga ai. Ai deklaroi se e tërheq amendamentin nr. 19.

Diskutimi i deputetit Faton Topalli është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----73,  
Kundër ----- 0 ,  
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/L-261 për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

### **3. Koha për pyetje parlamentare**

Deputetja Time Kadrijaj parashtrroi pyetje për zv/kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me mundësinë që personat e zhdukur të identifikuar të kategorizohen në kategorinë e viktimave civile të luftës.

Zv/kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Lumnije Morina parashtrroi pyetje për ministri Bernard Nikaj në lidhje me mosvazhdimin e autorizimit për Laboratorin SIERRA LAB SHPK, për testimin e derivateve të naftës edhe pse i njëjti, siç tha ajo i ka plotësuar të gjitha kushtet sipas Udhëzimit Administrativ 07/2012 të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Ministri Bernard Nikaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Lumnije Morina.

Deputeti Glauk Konjufca parashtrroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje atë se sa herë është ngritur çështja e shqiptarëve të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, në takimet që ai ka pasur me kryeministrin e Serbisë, në Bruksel.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Faton Topalli parashtrroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje atë se a e ka takuar kryeministri familjen e ndonjërit prej 46 veteranëve të luftës që janë vetëvrarë.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Nijazi Idrizi parashtrroi pyetje për ministrin Fehmi Mujota në lidhje kohën e fillimit të ndërtimit të rrugës Ferizaj- Gjilan – Dheu i Bardhë.

Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetit Nijazi Idrizi.

Deputetja Teuta Haxhiu parashtrroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje atë se çka kuptohet me koncept- planin kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike në Kosovë 2014 - 2018 dhe pse nuk është bërë publik ky plan?

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtrroi pyetje për zv/kryeministren Edita Tahiri në lidhje me atë se cili është qëndrimi i saj lidhur me heqjen e tabelave RKS nga automjeti privat i tij, nga ana e një pjesëtari të Policisë së Kosovës, në pjesën veriore të Mitrovicës.  
Zv/kryeministria Edita Tahiri nuk ishte e pranishme në sallë.

Deputeti Afrim Hoti parashtrroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje atë, siç tha ai ndalimin e mjekëve shqiptarë të Komunës së Mitrovicës për të shkuar në vendet e tyre të punës në pjesën veriore të Mitrovicës.  
Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albana Gashi parashtrroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me masat e ndërmarra nga Ministria që ai drejton lidhur me dyshimet për abuzime me pacientë të sëmurë mendor në Shtime.  
Ministri Nenad Rashiq nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Afrim Hoti parashtrroi pyetje për zv/kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje atë se a është duke përgatitur Ministria që ai drejton dokumentacionin me dëshmi lidhur me krimet e luftës të shtetit serb në Kosovë?  
Zv/kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Faton Topalli parashtrroi pyetje për ministri Nenad Rashiq në lidhje me numrin e pensionistëve në Kosovë të cilëve u ndërpritet pensioni si pasojë e procedurave administrative për paraqitje sipas afateve kohore, për të konfirmuar se ata janë gjallë.  
Ministri Nenad Rashiq nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Elmi Reçica parashtrroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me ndërrimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Rajonal në Ferizaj dhe caktimin e lokacionit të ri afër Kazermës Ushtarake, nga ana e Asamblesë Komunale në Ferizaj. Për ndërtimin e këtij spitali Qeveria e Kosovës ka ndarë mjete në rishikimin e buxhetit për vitin 2013.  
Ministri Ferid Agani u përgjigj pyetjes së deputetit Elmi Reçica.

Deputeti Elmi Reçica parashtrroi pyetje për ministrin Agim Çeku në lidhje me atë se a lejohet që Spitali civil të jetë pranë Kazermës Ushtarake dhe sa është e dëmshme që këto dy institucione të jenë pranë njëra- tjetrës? Çështja ka të bëjë me ndërrimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Rajonal në Ferizaj dhe caktimin e lokacionit të ri afër Kazermës Ushtarake nga Asambleja Komunale në Ferizaj.  
Ministri Agim Çeku u përgjigj pyetjes së deputetit Elmi Reçica.

\* \* \*

Në vazhdim, kryetari konstatoi se të pranishëm në sallë janë 46 deputetë dhe në mungesë të kuorumit i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 17:25 minuta.

\* \* \*

*E hënë, më 7 prill 2014, ora 12:00*  
*Vazhdimi i mbledhjes plenare*

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 3 prill 2014.

Ai procedoi me pikat, si në vijim:

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë për linjën kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim**

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, të paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë për linjën kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Ministri Besim Beqaj tha se ky projektligj mundëson ratifikimin e Marrëveshjes për garancinë shtetërore lidhur me garantimin e linjës kreditore nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në shumë prej 10 milionë euro dhe se qëllimi i linjës kreditore është rritja graduale e shumës së garantuar të depozitave nga 2 mijë euro në 3 mijë euro dhe mundësimi i qasjes në fonde, në rast të dështimit të ndonjë banke.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen në tërësi të projektligjit dhe ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë për linjën kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Diskutimi i ministrit Besim Beqaj është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë për linjën kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji e paraqiti deputetja Safete Hadergjonaj.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Safete Hadergjonaj - në emër të GP të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të GP të LDK-së, Faton Topalli - në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Xhevdet Neziraj - në emër të GP të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të GP të KKR-së, si dhe Faton Topalli, Naser Osmani, Ardian Gjini dhe ministri Besim Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 62 deputetë, ndërsa miratimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes kërkon votën e së paku dy të tretave të deputetëve të Kuvendit.

Procedimi me votim do të bëhet në momentin kur të plotësohet kuorumi në Kuvend.

#### **5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale**

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funkcional raportues për Projektligjin për produkte dhe pajisje medicinale.

Deputeti Fikrim Damka, në emër të Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e paraqiti dhe e arsyetoi para deputetëve raportin me rekomandime.

Në lidhje me amendamentet e propozuara dhe në përgjithësi për këtë pikë të rendit të ditës, diskutuan deputetët: Shaip Muja, Ismet Beqiri, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Bekim Haxhiu, Jakup Krasniqi, Faton Topalli, Ardian Gjini, Gëzim Kelmendi dhe ministri Ferid Agani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari më pas i hodhi në votim amendamentet, veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8A, 9, 10, 12, 13, 14, 15, 16, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 28, 29A, 30, 31, 32, 33, 34A, 35, 36, 37, 38, 39, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52A, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 70, 71, 72, 73, 74, 76, 77 dhe 78.

Kuvendi nuk i miratoi këto amendamente: 7, 8B, 11, 17, 18, 27, 29B, 40, 41, 60, 61, 68, 69 dhe 75.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----56,  
Kundër ----- 1 ,  
Abstenime -----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale.

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes së Kuvendit në orën 13:45 minuta.

\* \* \*

### **E enjte, më 10 prill 2014,**

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, të filluar më 3 e 7 prill 2014.

Ai procedoi me pikën, si në vijim:

#### **4. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë për linjën kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim**

Kryesuesi tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar, në seancën plenare më 7 prill 2014, mirëpo në mungesë të kuorumit, procedimi me votim është shtyrë.

Ai më tej sqaroi se miratimi i këtij projektligji kërkon së paku 80 vota “për” dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 81 deputetë.

Më pas kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë për linjën kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 80,  
Kundër----- 0,  
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

## V E N D I M

1. Miratohet Ligji nr.04/L-266 për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për linjën kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

2. Ligji i dërgohet për shpallje presidentes së Republikës së Kosovës.

Kryesuesi i mbylli punimet e mbledhjes plenare në orën 10:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*